

Udhëzim për grumbullimin e diferencuar të mbeturinave


Në Murano dhe Burano:

- **qeskat**, njëra me plehrat e mbetura dhe tjetra me mbeturinat e diferencuara sipas ditë së përcaktuar, duhen vendosur jashtë banesës, pranë derës së shtëpisë, **midis orës 6 dhe 8 të mëngjesit**.

Informacione në aplikacionin falas Veritas Scoasse

Gjoba prej 167 euro për ata që braktisin mbeturinat ose nuk kryejnë grumbullimin e diferencuar të mbeturinave.

LETRA KARTON DHE TETRAPAK të hënën, të mërkurën dhe të premten



po Gazeta, fletore, libra, zarfe, shirita, fotokopje, fleta, fletushka dhe libërtha prej letre; qese prej letre; kuti Tetrapak për pije dhe ushqime (lëng frutash, qumësht, verë, salcë dhe bishtajore); kutiza, kuti të mesme dhe kuti të mëdha kartoni; karton i valëzuar; karton për pica.

Kujdes: letra e ndotur me ushqim ose me materiale të tjera nuk duhet përzierë me letrat.

NDALOHET PËRDORIMI I QESKAVE PLASTIKE PËR GRUMBULLIMIN E LETRËS DHE KARTONIT

jo Letër e plastifikuar, kimike dhe e vajosur; letra dhe kartonë të ndotur me ushqim ose me substanca të tjera.

XHAM PLASTIKË DHE METALE të martën, të enjten dhe të shtunën



po Shishe, vazo, enë mbajtëse prej xhami, plastikë, alumin dhe metal; kova dhe magje; tubo dhe tubete bosh; kanaçe; celofan, letër alumin dhe shirit mbështjellës i tejdrukshëm; thasë, qeska, qese, qeska për pazar dhe rrjeta plastike; kuti dhe qeska për biskota, ëmbëlsira dhe patatina; pjata dhe gota plastike për një përdorim të vetëm pa mbetje ushqimore; bombola spray bosh; kapakë, kafaze dhe tapa.

Kujdes: materialet nuk duhet të përmbajnë mbetje ushqimi ose produkti

jo Porcelan, qeramikë dhe Pirex, gota xhami; kristali; pasqyra, lastra xhami, llamba dhe tubo neoni; lugë e pirunë plastike për një përdorim të vetëm; lodra dhe sende prej gome.


PLEHRA TË MBETURA nga e hëna në të shtunë



po Mbetje të kuzhinës dhe teprica të ushqimit; lule të prera dhe bimë shtëpiake; peceta letre të ndotura; shtraja për kafshët e vogla shtëpiake; gomë; lecka të ndotura; letra të vajosura, të plastifikuar dhe kimike; kartonë tepër të ndotur për pica ; lugë e pirunë plastike; pelena dhe peceta thithëse higjienike (Lines); gota xhami dhe kristali (nëse janë thyer, atëherë mbështillini në letra gazete); shiringa dhe gjilpëra me kapuç; qese për fshesat me korrent; sende të vogla prej druri; lodra të thyera pa përbërës elektrikë ose elektronikë; qeramikë, porcelan dhe deltinë e pjekur (baltë); kolora, gërshërë dhe stilolapsa; kaseta audio dhe video, floppy disk, cd.

jo Mbetje të rënda dhe inerte; letër, karton dhe Tetrapak; xham, plastikë dhe kanaçe.

MBETJE TË RËNDA DHE TË VEÇANTA



Ecomobile vetëm për banorët privatë

Përballë tregut të Rialto-s, nga e hëna në të shtunë (përfshirë ditët e pushimeve), orari 8-11 dhe 14-17 Tërheqje e mbeturinave të rrezikshme, baterive dhe grumbulluesve, kanaçeve me bojë, enëve bosh për vajin vegjetal për gatim, pajisje të vogla elektrike, për shembull mixer-a, ora me alarm, robotë kuzhine, tharëse flokësh, përbërës dhe aksesore informatikë.

Prenotim i tërheqjes në shtëpi të mbeturinave me përmasa të mëdha

Për të eliminuar mbetjet dhe sendet me përmasa të mëdha, ekskluzivisht me origjinë shtëpiake, mund të përdoret shërbimi në shtëpi, falas deri në një metër kub. Për të kërkuar takim:

- > sms në numrin 342.4112660 (duke treguar kodin e klientit që gjendet lart majtas në faturë, sendin që duhet eliminuar dhe adresën ku duhet kryer shërbimi);
- > e-mail a voluminosi.venezia@gruppoveritas.it;
- > fax në numrin 041.7292045;
- > telefononi në numrin e gjelbër falas 800.811.333, nga e hëna në të premte, 8.30-12.30 (me përjashtim të ditëve pushim).